



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
DEPARTAMENTI I STABILITETIT FINANCIAR

Raport¹

mbi ecurinë e treguesve që monitoron Banka e Shqipërisë, në kuadër të procesit të deeuroizimit

Gusht 2022

¹ Ky raport publikohet në zbatim të Memorandumit të Bashkëpunimit mes Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Bankës së Shqipërisë dhe Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, “Për zgjerimin e përdorimit të monedhës kombëtare në sistemin financiar dhe në ekonominë shqiptare”, nënshkruar më 18.4.2017 dhe publikuar në adresën e internetit:

https://www.bankofalbania.org/web/pub/memorandumi_gksf_9384_1.pdf

Përmbajtja

I. Hyrje.....	3
II. Përmbledhje.....	3
III. Ecuria e treguesve.....	5
IV. Konkluzion	12
Aneks I. Paketa e masave të Bankës së Shqipërisë në drejtim të deeuroizimit (Shkurt 2018), dhe treguesit e monitorimit	13
Aneks II. Veprime rregullative të mëparshme që ndikojnë në drejtim të deeuroizimit .	15
Aneks III. Vrojtimi për përdorimin e euros në vendet e Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore, kryer nga Banka Qendrore e Austrisë.....	16

I. Hyrje

Bazuar në Memorandumin e Bashkëpunimit me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, si dhe me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, nënshkruar në datën 18 prill 2017, Banka e Shqipërisë implementoi një paketë masash konkrete për të nxitur përdorimin e monedhës vendase. Paketa e masave, e cila u miratua me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë në shkurt 2018, përbëhet nga tre elemente kryesore: *i*) diferencimi i rezervës së detyrueshme për detyrimet në valutë dhe ato sipas afatit të maturimit në lek; *ii*) kërkesa më të larta për treguesit e likuiditetit në valutë; dhe *iii*) ndërgjegjësimi i huamarrësve për rrezikun që paraqet huamarrja në valutë. Efikasiteti i masave monitorohet përmes disa treguesve dhe vlerësohet në bazë të ndryshimit në nivelin e euroizimit të sistemit financiar, para dhe pas zbatimit të tyre. Më shumë detaje lidhur me masat dhe treguesit e përcaktuar për monitorimin e efektit të tyre jepen në Aneksin 1.

Rezultatet e këtij vlerësimi, si dhe gjykimi mbi përshtatshmërinë e masave për arritjen e objektivit (nxitja e përdorimit më të madh të monedhës kombëtare në ekonomi) komunikohen çdo gjashtëmuor, përmes publikimit të këtij raporti.

Sikurse theksohet në Memorandum, synimi i Strategjisë nuk është arritja e nivelit zero të përdorimit të monedhave të huaja, pasi niveli i hapjes së ekonomisë sonë me vendet partnere tregtare nënkupton praninë e rëndësishme të monedhave të huaja në sistemin tonë financiar. Objektivi është pakësimi i përdorimit të monedhave të huaja deri në një nivel që konsiderohet i natyrshëm për një ekonomi të ngjashme me atë shqiptare.

II. Përmbledhje²

Gjatë gjashtëmuorit të parë të vitit 2022, vërehen dy ndryshime kryesore: pakësimi i vlerës dhe i peshës së kredive në valutë të pambrojtura ndaj kursit të këmbimit; dhe rënia e “aktiveve likuide në valutë ndaj detyrimeve afatshkurtra në valutë”. Ecuria rënëse e treguesit të parë është një zhvillim i rëndësishëm pozitiv për uljen e profilit të rrezikut të veprimtarisë së kreditimit. Rënia e treguesit të likuiditetit është ndikuar nga rënia e tepricës së titujve likuidë në valutë, por treguesi mbetet gjithsesi mbi nivelet minimale të kërkuara. Përsa i përket treguesve të tjerë, ndryshimet janë më të lehta dhe ato kanë ruajtur nivele të përafërta me gjashtëmuorin e mëparshëm. Kështu, treguesi “kredi në valutë ndaj totalit të kredive” vijon të mbetet mbi nivelin 50%. Nga ana tjetër, pesha e depozitave në valutë në totalin e depozitave ka shënuar rritje të lehtë, në nivelin 53.2%. Në tërësi, këto zhvillime reflektojnë larminë e faktorëve që i ndikojnë treguesit e deeuroizimit, dhe

² Treguesit e monitoruar në këtë raport paraqiten të zhveshur nga efekti tremujor i luhatjeve në kursin e këmbimit të monedhës kombëtare ndaj monedhave kryesore të huaja (euro dhe dollar amerikan). Për matjen e efektit të kursit në portofolin e kredive të secilës bankë është përdorur formula: $X_t - X_{t-1} - (X_t/K_t - X_{t-1}/K_{t-1}) * K_{t-1}$. Ku, X përfaqëson vlerën në monedhën vendase, K është kursi i këmbimit i shprehur në lekë për njësi të valutës, dhe t është periudha e shprehur në tremujorë.

evidentojnë nevojën për zbatimin e masave të deeuroizimit me konsistencë, në mënyrë proaktive dhe të koordinuar ndërinstucionalisht.


Krahasuar me fundin e vitit 2021, në fund të muajit qershor 2022 janë vënë re këto ndryshime kryesore:

Depozitat – depozitat në valutë arritën në 53.2% të totalit të depozitave të klientëve, rreth 1.4 pikë përqindje (pp) më lart se fundi i gjashtëmujorit të kaluar dhe 2.3 pp më lart se një vit më parë. Depozitat mbi një vit në monedhën vendase kanë ruajtur nivel të përafërt me fundin e gjashtëmujorit të kaluar, duke shënuar nivelin 14.5% të totalit të depozitave;

Likuiditeti – aktivet likuide në valutë ndaj pasiveve afatshkurtra në valutë shënuan nivelin 26%, me një rënie të konsiderueshme prej 6.2 pp krahasuar me fundin e gjashtëmujorit të kaluar dhe 5.6 pp krahasuar me një vit më parë. Ndryshimi ka ardhur kryesisht për shkak të ndryshimit të strukturës dhe riklasifikimit në portofolet e titujve;

Kreditë – kreditë në valutë shënuan nivelin 51.2% të teprcës së kredive, ose 0.1 pp më shumë se fundi i dhjetorit 2021 dhe 1.4 pp më shumë se një vit më parë. Kreditë e pambuluara ndaj rrezikut të kursit të këmbimit përbëjnë 34.3% të kredive në valutë, 2.8 pp më pak se fundi i gjashtëmujorit të kaluar dhe 7 pp më pak se një vit më parë.

Grafik 1. Treguesit kryesorë për monitorimin e nivelit të përdorimit të valutës në sektorin bankar shqiptar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Shënim: Për secilin tregues, niveli i rrezikut është përcaktuar duke iu referuar një pragu krahasues. Për treguesit “depozita në valutë ndaj totalit të depozitave” dhe “kredi në valutë ndaj totalit të teprcës së kredisë”, pragu krahasues është niveli prej 30%, sipas gjykimit ekspert. Për vlera nën 30% të këtyre treguesve, niveli i rrezikut konsiderohet “i ulët” (ngjyra e gjelbër). Për treguesin “aktive likuide në valutë ndaj pasiveve afatshkurtra në valutë”, pragu krahasues llogaritet duke i shtuar një devijim standard të serisë kohore, kufirit rregullativ prej 20%. Për vlera më të ulëta se ky prag krahasues, treguesi sinjalizon “nivel të lartë” të rrezikut. Për treguesin e “depozitave me afat mbi një vit në lekë ndaj totalit të depozitave në lekë”, pragu krahasues është përcaktuar sipas gjykimit ekspert në nivelin 40%.

III. Ecuria e treguesve³

Ky kapitull përshkruan ecurinë e treguesve të listuar në Aneksin 1 të këtij materiali. Paraqitja e treguesve të zhveshur nga efektet e kursit të këmbimit synon përafrimin maksimal drejt matjes së ndikimit të masave. Siç vërehet në grafikët në vijim, zbatimi i paketës së masave ka pasur efekt gradual mbi treguesit e analizuar dhe ka qenë më i dukshëm në disa prej tyre.


Ecuria e Depozitave

Në fund të gjashtëmujorit të parë 2022, treguesi që mat *peshën e depozitave në valutë ndaj totalit të depozitave* shënoi nivelin 53.2%, ose 1.4 pp më i lartë se fundi i gjashtëmujorit të kaluar dhe 2.3 pp më i lartë se një vit më parë.

Në këtë tregues, totali i depozitave (emëruesi) ka treguar rritje me 1.9% krahasuar me fundin e gjashtëmujorit të kaluar dhe 8.9% krahasuar me një vit më parë. Sipas bankave, vlera me e lartë e rritjes së totalit të depozitave, në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar, ishte 11.8%.

Rritje kanë pësuar edhe depozitat në valutë (numëruesi) me 4.7% krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe 13.8% krahasuar me një vit më parë. Sipas bankave, vlera më e lartë e rritjes së depozitave në valutë, në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar, ishte 20.1%.

Grafik 2. Raporti i depozitave në valutë ndaj totalit të depozitave, për sistemin bankar



Burimi: Banka e Shqipërisë.


Shpërndarja e treguesit të mësipërm sipas bankave vijon të paraqitet relativisht simetrike, duke u luhatur në nivelet 48.1% deri në 61.9%. Rezulton se 10 nga 12 banka që operojnë në sistemin bankar shënojnë nivelin e peshës mbi 50% për këtë tregues (duke i bërë ato

³ Në këtë analizë janë rishikuar vlerat e T3 dhe T4 2018, për të reflektuar ndryshimet strukturore në sistemin bankar. Efekti i tyre ka qenë minimal dhe nuk ka pasur ndikim në konkluzionet e analizës.

subjekt të normës më të lartë të rezervës së detyrueshme prej 20%, për pjesën e depozitave në valutë që kapërcen atë peshë). Ecuria në rritje e normave të interesit të valutës në tregjet ndërkombëtare mund të përmirësojë marzhin e përdorimit të valutës nga bankat, dhe të shoqërohet me zbutjen e kostove të mësipërme.


Gjatë periudhës, treguesi i peshës së depozitave në valutë ka pësuar rënie vetëm për një prej bankave të sistemit, ndërkohë që ka njohur rritje për pjesën më të madhe të tyre, duke ndikuar në rritjen e peshës së depozitave në valutë. Në tërësi, shpërndarja e vlerave të treguesit për bankat jepet në Grafikon 3.

Grafik 3. Shpërndarja e treguesit të depozitave në valutë ndaj totalit të depozitave, për bankat e sistemit



Në vijim, *peshë e depozitave në lek me afat maturimi mbi një vit ndaj totalit të depozitave* ka ruajtur një vlerë të përafërt me gjashtëmujorin e kaluar në nivelin 14.5%. Treguesi ra gjatë kësaj periudhe me 0.3 pp krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe është rritur me 0.4 pp krahasuar me një vit më parë.


Grafik 4. Raporti i depozitave mbi një vit në lekë ndaj totalit të depozitave në lekë, për sistemin bankar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Shpërndarja e treguesit të mësipërm sipas bankave vijon të jetë e gjerë dhe reflektohet në vlerat e minimumit dhe maksimumit, të cilat variojnë nga 0.3% në 39.9%. Ndërkohë, 6 prej tyre e kanë vlerën e raportit më të lartë se vlera mesatare e sektorit.

Grafik 5. Shpërndarja e raportit të depozitave mbi një vit në lekë ndaj totalit të depozitave në lekë, për bankat e sistemit



Burimi: Banka e Shqipërisë.


Ecuria e Aktiveve Likuide

Treguesi i likuiditetit “aktive likuide në valutë ndaj detyrimeve afatshkurtra në valutë” vijon të mbetet mbi nivelet minimale, si në lek ashtu edhe në valutë. Duke iu referuar këtij treguesi në nivel sektori, konstatohet se ai ka shfaqur një ecuri rënëse gjatë tre tremujorëve të fundit, duke shënuar nivelin 26% në fund të qershorit 2022. Treguesi është reduktuar me 6.2 pp krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe ka shënuar rënie me 5.6 pp krahasuar me një vit më parë.

Aktivet likuide në valutë (numëruesi) janë tkurrur me 15.7% krahasuar me fundin e gjashtëmujorit të kaluar dhe me 6.2% krahasuar me një vit më parë. Sipas bankave, vlera më e lartë e rënies së aktiveve likuide në valutë, në krahasim me gjashtëmujorin e mëparshëm, rezultoi 42.6%, ndërkohë që rritja më e madhe ka qenë 47.4%. Në rënie e aktiveve likuide kanë ndikuar kryesisht ndryshimet në strukturën dhe klasifikimin e disa titujve.

Ecuria e detyrimeve afatshkurtra në valutë (emëruesi) ka shënuar rritje krahasuar me fundin e gjashtëmujorit të kaluar dhe një vit më parë, me përkatësisht 4.4% dhe 14%. Në nivel bankash, vlera më e lartë e rritjes së detyrimeve afatshkurtra në valutë, në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar, rezultoi 23.2%, ndërsa rënia më e madhe 3.3%.


Grafik 6. Ecuria e treguesit të aktiveve likuide në valutë ndaj pasiveve afatshkurtra në valutë, për bankat e sektorit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Shpërndarja e vlerave të treguesit për valutën sipas bankave të sektorit (Grafiku 7) tregon se ai reflekton një shpërndarje relativisht të gjerë.

Grafik 7. Shpërndarja e treguesit të aktiveve likuide në valutë ndaj pasiveve afatshkurtra në valutë, për bankat e sektorit




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ecuria e Kredisë

Gjatë gjysmës së parë të vitit 2022, rritja dyshifrore e kreditimit u mbështet nga ecuria e mirë e kreditimit në lek dhe në valutë, por kjo e fundit shënoi një rritje disi më të lartë. Pesha e kredisë në valutë në portofolin e bankave paraqitet e qëndrueshme krahasuar me fundin e vitit të kaluar.


Grafik 8. Raporti i kredive në valutë ndaj totalit të kredive, për sektorin bankar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në grafikun 9 paraqitet shpërndarja e peshave të kredisë në valutë sipas bankave, ku konstatohet një shpërndarje e gjerë e treguesit, i cili është luhatur midis vlerave 32.5% dhe 74.25% në fund të qershorit 2022. Pesha e kredisë në valutë është rritur në portofolet e shumicës së bankave të sektorit gjatë periudhës, gjë që reflektohet në një vlerë më të lartë të mesatares dhe të medianës. Krahasuar me katër vite më parë, treguesi është ulur për shumicën e bankave, por me një intensitet të ndryshëm. Ky konfigurim pasqyron heterogjenitet në ecurinë e bankave në drejtim të uljes së nivelit të eurozimit të tyre.


Grafik 9. Shpërndarja e raportit të kredive në valutë ndaj totalit të kredive, për bankat e sektorit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Me gjithë vijimin e rritjes së kredisë në valutë, teprica e kredive në valutë të pambrojtura nga kursi i këmbimit (ku mbizotërojnë ato në euro me rreth 90%) vazhdoi të bjerë gjatë gjashtëmujorit. Kjo rënie ishte rreth 5.2 mld lekë ose rreth 4%, në terma vjetorë. Në fund të periudhës, këto kredi përbënin 34.3% të kredive në valutë, ose 17.4% të totalit të kredisë. Rënia e vlerës absolute të kredive të pambrojtura në valutë ka dhënë ndikimin kryesor në ecurinë e këtyre raporteve. Ky është një zhvillim i rëndësishëm, pasi ndër kreditë në valutë, kreditë e ekspozuara ndaj rrezikut të kursit të këmbimit (domethënë, ku të ardhurat e subjektit huamarrës janë në monedhë të ndryshme nga monedha e përfitimit të kredisë) janë ato me profilin më të lartë të rrezikut.


Grafik 10. Raporti i kredive në valutë të pambrojtura për rrezikun e kursit të këmbimit ndaj totalit të kredive në valutë, për sektorin bankar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në nivel bankash, konstatohet se treguesi ka ardhur në përmirësim (rënie) për shumicën e tyre. Sipas grafikut 11, vërehet se shumica e bankave kanë një vlerë të treguesit nën mesataren e sektorit, dhe shpërndarja e gjerë e treguesit ndikohet nga përbërja e portofolit të tre bankave, të cilat shënojnë vlera mbi kuartilin e tretë prej 41.4%.

Grafik 11. Shpërndarja e peshës së kredive në valutë të pambrojtura nga rreziku i kursit të këmbimit ndaj totalit të kredive në valutë, për bankat e sistemit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ecuria e Borxhit Publik


Transaksionet financiare të lidhura me nivelin dhe ecurinë e borxhit publik në valutë, ruajnë nxitjen për përdorimin e valutës në ekonomi, duke kontribuar në drejtim të kundërt me masat e deeuroizimit. Për këtë arsye, ecuria e përbërjes së borxhit publik monitorohet si pjesë e kësaj analize.

Në fund të marsit 2022⁴, vërehet:

- 1) rritje e peshës së letrave me vlerë të borxhit (titujve) me maturitet më të gjatë se 12 muaj (obligacione 2-vjeçare dhe 10-vjeçare);
- 2) rritje në masën 9.57% e peshës së detyrimeve në valutë të qeverisë shqiptare krahasuar me fundin e shtatorit 2021;
- 3) rënie e borxhit të brendshëm në masën 8.44% krahasuar me fundin e shtatorit 2021.

Në fund të marsit 2022, borxhi publik në valutë zinte 51.3% të totalit të borxhit publik, duke u rritur me gati 8.4pp gjatë gjashtë muajve paraardhës. Ai mbizotërohet nga borxhi në euro, i cili zë gati 70% të vlerës së borxhit në valutë.

Grafik 12. Ecuria e borxhit publik në lekë dhe valutë (boshti majtas), si dhe pesha e borxhit publik në lekë ndaj totalit (boshti djathtas)



Burimi: Të dhënat janë marrë nga faqja e internetit e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe janë përpunuar nga Banka e Shqipërisë.


Ecuria e Kursit të Këmbimit

Gjatë periudhës janar - qershor 2022, luhatshmëria e monedhës vendase ka shënuar nivele të përafërta me periudhat e kaluara.

Kundrejt euros, leku është mbiçmuar lehtë në dy 3-mujorët e fundit. Kjo ecuri përkon me sjelljen sezonale të viteve të fundit, ku gjatë muajve mars-prill vihet re një mbiçmim i lekut ndaj euros.

⁴ Të dhënat më të fundit të publikuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë deri në momentin e publikimit të këtij raporti i referohen fundit të muajit mars 2022.

Grafik 13. Ecuria e kursit të këmbimit të lekut ndaj dy valutave kryesore



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Kundrejt dollarit amerikan, në terma vjetorë, vihet re një nënçmim i lekut gjatë muajve të parë të vitit, duke reflektuar përgjithësisht ecurinë e kursit të këmbimit EUR/USD në tregjet ndërkombëtare.

Në situata kur kursi i këmbimit është i qëndrueshëm dhe luhatshmëria e tij është e ulët, agjentët ekonomikë kanë tendencën të rrisin volumin dhe frekuencën e transaksioneve të tyre financiare në valutë. Kjo shoqërohet në përgjithësi me rritje të shkallës së përdorimit të valutës dhe ulje të vigjilencës ndaj rreziqeve që shoqërojnë ekspozimin e tyre ndaj saj. Si rezultat, lëvizjet e papritura në kursin e këmbimit mund të nxisin transaksione të sforcuara në tregje nga ana e agjentëve, të cilat mund të rrisin pasigurinë për zhvillimet e përgjithshme ekonomike. Ndaj është e rëndësishme që në situata të zhvillimeve normale, të tërhiqet vëmendja e agjentëve ekonomikë për nevojën e kontrollit mbi nivelin dhe pozicionin e tyre në valutë, duke theksuar që kursi i këmbimit të lekut është i lirë dhe lëvizjet e tij në të dy kahet janë të mundshme. Në nivel makro, fleksibiliteti i kursit të këmbimit është një mekanizëm i rëndësishëm mbrojtës për zbutjen e goditjeve makroekonomike.

IV. Konkluzion

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2022, ecuria e treguesve që monitorohen në kuadër të deeuroizimit ka qenë e larmishme. Nga njëra anë, kemi rënie të vlerës dhe të peshës së kredisë në valutë të pambrojtur nga kursi i këmbimit. Kjo ecuri ndodh prej disa periudhash dhe përfaqëson një kontribut të rëndësishëm në uljen e profilit të rrezikut të portofolit të kredisë për bankat. Është e dëshirueshme që kjo ecuri të vazhdojë. Nga ana tjetër, depozitat në valutë kanë ruajtur një peshë të rëndësishme në totalin e depozitave, dhe depozitat me afat mbi një vit në lek ende nuk kanë treguar ndonjë prirje rritëse, pavarësisht rritjes së normave të interesit. Treguesi i likuiditetit në valutë, ndonëse ka shënuar rënie gjatë periudhës, mbetet mbi nivelet minimale të kërkuara. Në tërësi, këto zhvillime reflektojnë larminë e faktorëve që i ndikojnë treguesit e deeuroizimit, dhe evidentojnë nevojën për zbatimin e masave të deeuroizimit me konsistencë, në mënyrë proaktive dhe të koordinuar ndërinstitucionalisht.

Aneks I. Paketa e masave të Bankës së Shqipërisë në drejtim të deeuroizimit (Shkurt 2018), dhe treguesit e monitorimit

Masa 1. Për të rritur peshën e monedhës vendase dhe njëkohësisht zgjerimin e maturitetit në strukturën e detyrimeve të sistemit bankar, **Banka e Shqipërisë vendosi të diferencojë normën e rezervës së detyrueshme⁵**, për kategoritë e përfshira në bazën e rezervës së detyruar, si vijon:

- 7.5% (nga 10% që ishte më parë) për detyrimet në lekë me afat maturimi jo më të gjatë se 12 muaj;
- 5% (nga 10% që ishte më parë) për detyrimet në lekë me afat fillestar më të gjatë se 12 muaj deri në 2 vjet;
- 12.5% (nga 10% që ishte më parë) për detyrimet në valutë, kur këto zënë nën 50% të totalit;
- 20% (nga 10% që ishte më parë) për pjesën e detyrimeve në valutë mbi 50% të totalit.

Monitorimi i efekteve të Masës 1 bëhet nëpërmjet treguesve në vijim:

- *raportit të depozitave në valutë, të zhveshur nga efektet e kursit të këmbimit ndaj totalit të depozitave;*
- *raportit të depozitave mbi një vit⁶ në lekë, ndaj totalit të depozitave në lekë;*
- *ecurisë së strukturës së borxhit publik.*

Masa 2. Për administrimin më të kujdesshëm të rrezikut të likuiditetit, **Banka e Shqipërisë vendosi të rrisë kërkesën minimale rregullative për aktivet likuide në valutë⁷** në nivelin 20% të detyrimeve afatshkurtra. Për aktivet likuide në lekë, raporti u ruajt në nivelin prej 15%.

Monitorimi i efekteve të Masës 2 do të bëhet nëpërmjet treguesit në vijim:

- *raporti i aktiveve likuide në valutë ndaj detyrimeve afatshkurtra në valutë, të zhveshura nga efekti i kursit të këmbimit.*

⁵ Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 13, datë 7.2.2018, “Për miratimin e normës së rezervës së detyruar mbajtur në Bankën e Shqipërisë nga bankat”.

⁶ Ky tregues u konvertua për të shfaqur ecurinë e peshës së depozitave në lekë mbi një vit, si synim i drejtpërdrejtë i uljes së normës së rezervës së detyrueshme në lek.

⁷ Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 14, datë 7.2.2018, “Për një ndryshim në rregulloren për administrimin e rrezikut të likuiditetit”.

Masa 3. Për rritjen e **ndërgjegjësimit të huamarrësve në lidhje me rrezikun e kursit të këmbimit**, Banka e Shqipërisë u ka kërkuar bankave⁸ që:

- në rastet kur klienti aplikon për kredi në monedhë të ndryshme nga monedha në të cilën ka të ardhurat, bankat t'i propozojnë huamarrësit një kredi alternative në të njëjtën monedhë me të ardhurat e tij, si dhe ta pajisin atë me një shembull konkret se si ndryshon kësti i kredisë në rast nënçmimi të lekut dhe/ose rritjeje të normës së interesit (me vlera të përcaktuara);
- të përfshijnë në kontratat e reja të kredisë në valutë (apo ato që ristrukturohen rishtas), opsionin për përdorimin e mekanizmave që zbusin rrezikun e tregut për kredimarrësin, në rastin kur plotësohen kushtet e dakorduara nga banka dhe huamarrësi.

Monitorimi i efektit të Masës 3 bëhet nëpërmjet treguesve në vijim:

- *kredia në valutë ndaj totalit të portofolit, zhveshur nga efekti i kursit të këmbimit;*
- *kredia në valutë e pambrojtur nga kursi i këmbimit, ndaj totalit të kredive në valutë, zhveshur nga efekti i kursit të këmbimit;*
- *rezultatet e vrojtimit të nivelit të përdorimit të euros në vendet e Evropës Qendrore e Juglindore (EQJL) që përgatitet një herë në vit nga Banka Qendrore e Austrisë (përfshihet vetëm në raportin e publikuar në verë).*

⁸ Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 15, datë 7.2.2018, “Për disa ndryshime në rregulloren mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare”.

Aneks II. Veprime rregullative të mëparshme që ndikojnë në drejtim të deeuroizimit

Nr.	Masa	Data e adoptimit/e zbatimit	Përshkrim
1.	Kufizimi i huave në valutë të pambrojtura nga rreziku i kursit të këmbimit	Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës nr. 62, datë 14.9.2011, “Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja”, neni 15	Huatë në valutë, të dhëna për huamarrësit e pambrojtur nga rreziku i kursit të këmbimit (pra, ku të ardhurat e huamarrësit janë në lekë), nuk duhet të kapërcejnë nivelin 400% të vlerës së kapitalit rregullator të bankës. Çdo vlerë mbi këtë nivel, zbritet nga vlera e kapitalit rregullator.
2.	Kërkesa minimale për aktive likuide në valutë	Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës nr. 75, datë 26.10.2011, dhe nr. 28, datë 27.3.2013	Vendosja e një kërkesë minimale për vlerën e raportit të aktiveve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra, në nivelin 15%, e zbatueshme veçmas për lekun dhe për valutat kryesore (euro, dollar amerikan), dhe në total në nivelin 20%.
3.	Kërkesa më e lartë për kapital, lidhur me huatë në valutë të pambrojtura nga rreziku i kursit të këmbimit	Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës nr. 48, datë 31.7.2013, “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”	Huatë në valutë ndaj huamarrësve të pambrojtur nga rreziku i kursit të këmbimit, ponderohen me koeficient më të lartë rreziku (150%), për qëllime të llogaritjes së treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit të bankës.

Aneks III. Vrojtimi për përdorimin e euros në vendet e Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore, kryer nga Banka Qendrore e Austrisë

Me qëllim vlerësimin e shkallës së përdorimit të euros në vendet e Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore, Banka Qendrore e Austrisë (Oesterreichische Nationalbank, shkurt OeNB) kryen që prej vitit 2007 një vrotim periodik, i cili mbledh informacion mbi shkallën e zëvendësimit të monedhës vendase me euron, në shtetet që janë pjesë e vrotimit, si dhe aspekte të tjera që lidhen me pritshmëritë dhe opinionet e individëve. Aktualisht, vrotimi i OeNB-së kryhet në dhjetë vende, ndër të cilat gjashtë janë anëtare të BE-së⁹ dhe katër nuk janë anëtare¹⁰, përfshirë këtu edhe Shqipërinë.

Vrojtimi ofron një burim informacioni gjithëpërfshirës mbi nivelin e euroizimit të aktiveve dhe detyrimeve të individëve, besimin dhe pritshmëritë e tyre ndaj euros dhe monedhës vendase, si dhe nivelin e njohurive financiare që ata zotërojnë. Mënyra e ndërtimit të tij lejon krahasime në kohë jo vetëm midis vendeve, por edhe midis grupeve socio-demografike. Gjithashtu, të dhënat në nivel mikro që ky vrotim nxjerr, ofrojnë informacion cilësor shtesë mbi përcaktuesit e euroizimit në vendet e shqyrtuara.

Deri në vitin 2014, vrotimi realizohej dy herë në vit dhe, duke filluar prej vitit 2015, frekuenca u reduktua në një herë në vit. Për kryerjen e vrotimit përzgjidhen dhe intervistohen në mënyrë rastësore 1000 persona nga secili vend. Kampioni i përzgjedhur përfshin popullatën e individëve mbi 14 vjeç dhe është përfaqësues në lidhje me moshën, gjininë dhe shpërndarjen rajonale.

Në kuadër të raportit të deeuroizimit, kemi përzgjedhur të evidentojmë disa tregues që lidhen me vlerësimin e besimit dhe pritshmërive të individëve ndaj monedhës vendase, si dhe me nivelin e njohurive financiare të tyre.

Në tërësi, përgjigjet e individëve të intervistuar në Shqipëri reflektojnë një luhatshmëri më të lartë për vitin 2021, kufizime në drejtim të edukimit për çështjet e njohjes dhe të administrimit të rreziqeve financiare, si edhe qëndrueshmëri në drejtim të preferencës për përdorimin e euros.

Në vijim paraqiten treguesit e publikuar nga OeNB-ja në faqen e saj zyrtare¹¹.

Niveli i përgjithshëm i euroizimit për vendet pjesëmarrëse në vrotim

Vendet e Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore janë karakterizuar nga një përdorim i gjerë i valutave në ekonomi dhe i euros në mënyrë të veçantë. Indeksi i euroizimit është një tregues i përgjithshëm i shkallës së euroizimit të ekonomive pjesëmarrëse në vrotim, i ndërtuar duke kombinuar të dhëna mikro të vrotimit që lidhen me mbajtjen e parasë

⁹ Vendet anëtare të BE-së të përfshira në vrotim janë: Bullgaria, Kroacia, Polonia, Rumania, Republika Çeke dhe Hungaria.


¹⁰ Vendet joanëtare të BE-së të përfshira në vrotim janë: Shqipëria, Bosnje-Hercegovina, Maqedonia e Veriut dhe Serbia.

¹¹ Rezultatet e vrotimit mund të gjenden në adresën:
<https://www.oenb.at/en/Monetary-Policy/Surveys/OeNB-Euro-Survey.html>

fizike (cash) në euro, si edhe me të dhënat makro të depozitave në valutë të individëve (Scheiber dhe Stix, 2009), më specifikisht sipas formulës: $[para\ fizike\ (cash)\ në\ euro\ për\ frymë + depozitat\ në\ valutë\ për\ frymë] / (totali\ i\ parasë\ fizike\ për\ frymë\ në\ qarkullim + totali\ i\ depozitave\ për\ frymë)$.

Referuar këtij indeksi, gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, shkalla e euroizimit të asetëve të individëve, në terma absolutë, varion nga nivele mesatare deri në të larta për disa vende, edhe pse treguesi për shumicën prej tyre mund të ketë ardhur në rënie (Scheiber, 2019). Bazuar në rezultatet e fundit, niveli i euroizimit gjatë vitit 2021 është rritur për 6 nga 10 vendet e shqyrtuara, kryesisht si rezultat i rritjes së mbajtjes së parasë fizike në euro, një dukuri e shprehur më së shumti në vendet e rajonit, ku kryeson Maqedonia e Veriut, ndjekur nga Serbia dhe Shqipëria. Për Shqipërinë, shuma e parasë fizike për frymë që mbahet nga individët në euro është rritur, duke u rikthyer në nivele të ngjashme me mesataren e vitit 2011-2012. Po ashtu, edhe preferenca e individëve për të ruajtur kursimet në euro është rritur, duke bërë që indeksi i euroizimit të prekë nivele disi më të larta krahasuar me mesataren historike.

Grafik 14. Indeksi i euroizimit



Burimi: Vrojtimi për Euron nga OeNB.

Besimi dhe pritshmëritë e individëve


Vrojtimi mbledh informacion për besimin e individëve ndaj euros dhe monedhës vendase, si dhe bën krahasimin mes tyre. Ai vlerëson besimin e individëve ndaj institucioneve si: BE-ja, institucionet qeverisëse në vendet përkatëse, si dhe bankat. Gjithashtu, vrojtimi ndjek pritshmëritë e individëve për situatën financiare në familjet e tyre dhe më gjerësisht për situatën ekonomike në vendet e tyre të rezidencës.

Gjatë vitit 2021, rezultatet e besimit në institucionet e BE-së dhe bankat shfaqen më heteregjone, ndërsa besimi në institucionet qeverisëse ka rënë në të gjitha vendet pjesëmarrëse. Në Shqipëri, rezultatet e besimit të individëve ndaj këtyre tre komponentëve kanë shënuar historikisht nivele të larta, duke u renditur ndër të parët krahasuar me vendet e tjera pjesëmarrëse në vrojtimit. Viti 2021 ka shënuar një rënie të

besimit të individëve shqiptarë tek institucionet qeverisëse, BE-ja dhe bankat. Megjithatë, Shqipëria vijon të renditet e para për besimin tek bankat dhe e dyta për besimin tek institucionet qeverisëse.

Sa i përket besimit të individëve që depozitat e tyre në sistemin bankar janë të sigurta, Shqipëria vijon të shënojë kuotat më të larta krahasuar me vendet e tjera, dhe ky besim ka ardhur në rritje gjatë vitit të fundit. Në lidhje me nivelin e besimit ndaj monedhës vendase, se ajo do të jetë e qëndrueshme dhe e besueshme në pesë vitet e ardhshme, rezultatet për Shqipërinë kanë shënuar rënie gjatë 2021.

Grafik 15. Besimi në monedhën vendase sipas vendeve anëtare të BE-së (grafiku majtas) dhe vendeve kandidatë apo kandidatë potenciale (grafiku djathtas)




Burimi: Vrojtimi për Euro-n nga OeNB.

Shënim: Për llogaritjen e ecurisë janë përdorur mesataret e kampionit të secilit vend (-2.5 “jam plotësisht kundër,” 0 “jam neutral,” +2.5 “jam plotësisht dakord”). Të anketuarit u pyetën nëse janë apo jo dakord sipas shkallës 1 (plotësisht dakord) deri në 6 (plotësisht kundër) në lidhje me pyetjen: “Sa dakord jeni me shprehjen në vijim: Në pesë vitet e ardhshme monedha vendase do të jetë shumë e qëndrueshme dhe e besueshme.”

Po ashtu, kur të intervistuarve u kërkohet të krahasojnë euron dhe monedhën vendase sa i përket besueshmërisë dhe qëndrueshmërisë në të ardhmen, individët më së shumti vijnë të vlerësojnë më shumë monedhën euro. Vlerat pozitive në grafikun më poshtë tregojnë që vlerësimi i stabilitetit dhe besueshmërisë së euros është relativisht më i lartë në krahasim me monedhën vendase. Në rastin e Shqipërisë, është vërejtur një trend përmirësues në drejtim të besimit ndaj lekut deri në fillimet e krizës së vitit 2020, kur ky trend u kthye. Gjatë vitit 2021 u zgjerua edhe më tej diferenca midis besimit në euro dhe monedhës vendase, duke shënuar nivelet më të larta krahasuar me vendet e rajonit.

Grafik 16. Niveli relativ i besimit ndaj euros në krahasim me monedhën vendase për vendet anëtare të BE-së (grafiku në të majtë) dhe vendet candidate apo candidate potenciale (grafiku në të djathtë)




Burimi: Vrojtimi për Euro-n nga OeNB.

Shënim: Për llogaritjen e ecurisë janë përdorur mesataret e kampionit të secilit vend (-2.5 “jam plotësisht kundër,” 0 “jam neutral,” +2.5 “jam plotësisht dakord”). Të anketuarit u pyetën nëse janë apo jo dakord sipas shkallës 1 (plotësisht dakord) deri në 6 (plotësisht kundër) në lidhje me pyetjen: “Sa dakord jeni me shprehjen në vijim: Në pesë vitet e ardhshme, euro kundrejt monedhës vendase do të jetë shumë e qëndrueshme dhe e besueshme.”

Një vrojtimin e fundit gjithashtu vërehet rritja e përqindjes së të anketuarve shqiptarë që planifikojnë të marrin kredi në monedhë të huaj brenda vitit të ardhshëm. Kjo vlerë është më e larta për të gjitha vendet e anketuara (duke përjashtuar Kroacinë, e cila planifikon të hyjë në Eurozonë dhe të përdorë monedhën e përbashkët euro prej 1 janarit 2023).

Grafik 17. Kërkesa për kredi në monedhë të huaj në vendet e rajonit




Burimi: Vrojtimi për Euro-n nga OeNB.

Shënim: Në paraqitjen grafike janë përjashtuar të anketuarit që u përgjigjën “nuk e di” apo ata që refuzuan të përgjigjen. Pyetja e shtruar në grafikun 16 majtas është: “A planifikoni të merrni kredi brenda vitit të ardhshëm?”, ndërsa pyetja e shtruar në grafikun 16 djathtas është: “A planifikoni të merrni kredi në monedhë të huaj brenda vitit të ardhshëm?”.

Njohuritë financiare të individëve në Shqipëri

Për vlerësimin e njohurive të individëve në secilin vend, vrojtimi përdor një metodë standarde të aplikuar gjerësisht edhe nga vende të tjera¹². Vrojtimi adreson njohuritë e individëve në katër fusha kryesore: normat e interesit, norma e inflacionit, kursi i këmbimit dhe rreziqet financiare. Sipas vrojtimit, individët në Shqipëri paraqesin nivel më të ulët ose pranë vlerës mesatare të rajonit në lidhje me njohuritë mbi rreziqet financiare, siç janë ai i kursit të këmbimit, i normës së interesit dhe i inflacionit. Për më shumë informacion referojuni grafikëve në vijim.


Grafik 18. Niveli i njohurive për normën e interesit sipas vendeve
(mesatarja 2011 – 2020, si % e përgjigjeve)



Burimi: Vrojtimi për Euro-n nga OeNB.

Shënim: Pyetja e bërë është: “Supozoni që keni 100 [njësi parash në monedhë vendase] në llogari kursimi dhe norma e interesit ishte 2% në vit. Duke injoruar çdo tarifë tjetër bankare, sa do të keni në llogarinë tuaj pas 5 viteve nëse do t’i linit paratë të shtoheshin në llogari: më shumë se 102, ekzaktësisht 102, më pak se 102 [njësi parash në monedhë vendase].”

Grafik 19. Niveli i njohurive për inflacionin sipas vendeve
(mesatarja 2011 – 2020, si % e përgjigjeve)




Burimi: Vrojtimi për Euro-n nga OeNB.

¹² Metoda e përdorur është prezantuar për herë të parë nga Lussardi dhe Mitchell “Financial Literacy and Planning: Implications for Retirement Wellbeing”, 2004.

Shënim: Pyetja e bërë është: “Supozoni që norma e interesit në llogarinë tuaj të kursimit ishte 4% në vit dhe inflacioni 5% në vit. Duke injoruar çdo tarifë tjetër bankare – pas 1 viti, do të mund të blini më shumë, ekzaktësisht njësoj, apo më pak se sot me paratë në këtë llogari?”
 Nga tabela e rezultateve janë përjashtuar të anketuarit që refuzuan të përgjigjen.

Grafik 20. Niveli i njohurive për kursin e këmbimit sipas vendeve
 (mesatarja 2011 – 2020, si % e përgjigjeve)




Burimi: Vrojtimi për Euro-n nga OeNB.

Shënim: Pyetja e bërë është: “Supozoni që keni marrë një kredi në euro. Më pas kursi i këmbimit për monedhën vendase zhvlerësohet kundrejt euros. Si do të ndikojë kjo në shumën e parasë në monedhë vendase që do t’ju duhet për të paguar kështu e kreditit? Paga e kështu rritet / qëndron e pandryshuar / ulet.

Nga tabela e rezultateve janë përjashtuar të anketuarit që refuzuan të përgjigjen.

Grafik 21. Niveli i njohurive për rrezikun financiar sipas vendeve
 (mesatarja 2011 – 2020, si % e përgjigjeve)



Burimi: Vrojtimi për Euro-n nga OeNB.

Shënim: Pyetja e bërë është: “Në rastin kur një investitor shpërndan paratë e tij në aktive të ndryshme, rreziku për të humbur para rritet / ulet / nuk ndryshon?”

Nga tabela e rezultateve janë përjashtuar të anketuarit që refuzuan të përgjigjen.